

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve F. P., nga Komuna e Pejës, G. P., nga Komuna e Pejës, H.A., nga Komuna e Pejës, të cilët i përfaqëson A. N., avokat nga Peja, kundër të paditurës B. K. e S., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqësojnë V. H. dhe T. Xh., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paditësve dhe revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1860/2013 datë 25.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 10.5.2017, merr këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1860/2013 datë 25.11.2016.

PRANOHET pjesërisht revizioni i të paditurës në pjesën që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe për frikën e përjetuar për të gjithë paditësit, ashtu që **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1860/2013 datë 25.11.2016, dhe ai i Gjykatës Themelore, Pejë C.nr.520/2010 datë 16.4.2013, dhe detyrohet e paditura t'i paguajë: paditësit F.P. për zvogëlimin e aktivitetit jetësor 25% shumën prej 10.000 €, për frikën e përjetuar shumën prej 3000 €; paditësit G. P. për zvogëlimin e aktivitetit jetësor 35% shumën prej 13.500 €, për frikën e përjetuar shumën prej 3000 €; paditësit H. A. për zvogëlimin e aktivitetit jetësor 40% shumën prej 15.000 €, për frikën e përjetuar shumën prej 3000 €; ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e gjykuar refuzohet si i pabazuar. Të gjitha shumat e aprovuara obligohet e paditura t'i paguaj me kamat të precizuar si në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1860/2013 datë 25.11.2016, është provuar pjesërisht ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr. 520/2010 datë 16.4.2013, si në vijim:

Në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit F. P., sa i përket dëmit jomaterial për dhimbje të përjetuara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka detyruar të

paditurën, që paditësit, t'ia paguajë shumën prej 12.500 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për këtë kategori të dëmit përtej kësaj shume është refuzuar si e pabazuar.

Në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit G. P., sa i përket dëmit jomaterial për dhimbjet e përjetuara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka detyruar të paditurën, që paditësit, t'ia paguajë shumën prej 17.500 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për këtë kategori të dëmit përtej kësaj shume është refuzuar si e pabazuar.

Në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit H. A., sa i përket dëmit jomaterial për dhimbjet e përjetuara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguajë shumën prej 20.000 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë është refuzuar si e pabazuar.

Në pjesën e kërkesëpadisë së paditësve F. P., G. P. dhe H. A., aktgjykimi i cekur është ndryshuar edhe lidhur me kumatën e gjykuar, ashtu që në këtë pjesë është detyruar e paditura që paditësve për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t'ua paguajë kumatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për 1 vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë më datë 16.4.2013, e deri në pagesën definitive. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, në pjesën tjetër të kërkesëpadisë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësit me kohë kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet në pjesën I të dispozitivit, ashtu që të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

E paditura me kohë ka paraqitur revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që të aprovohen shumat më të ulëta për kompensim, ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Paditësit kanë paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës me propozim që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pabazuar, ndërsa të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i paditësve është i pabazuar.

Revizioni i të paditurës është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 23.12.2009 në rrugën regionale Gjakovë – Klinë, vozitësi A.Gj. , duke drejtuar automjetin e markës ” Renault ”Pik Up, me targa të regjistrimit ..., i siguruar te e paditura, duke mos ia përshtatur shpejtësinë e vozitjes kushteve të rrugës dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacion,humb kontrollin në automjet, kalon në shiritin e majtë të drejtimit dhe e godet me pjesën frontale automjetin e markës ”Mercedes tip 210 D - KB” në të cilin automjet si bashkudhëtar ishin këtu paditësit, me ç’rast të njëjtit nga goditja pësojnë lëndime të rëndë trupore dhe si pasojë tek paditësit kanë shkaktuar dhimbje trupore , frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtim, nevojën për ndihmën e personit tjetër, ushqim të përforcuar dhe shpenzime të mjekimit.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material e material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit për dhimbjet trupore, frikë, shëmtim trupor, nevojën për ndihmën e personit tjetër, ushqim të përforcuar dhe shpenzime të mjekimit, por lidhur me zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka aprovuar ankesën e të paditurës ashtu që ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka obliguar të paditurën që paditësve t’u paguaj shumat si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët mbi gjendjen e vërtetuar faktike, drejt dhe në mënyrë të plotë, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit për paditësin F. P., për dhimbje fizike shumë prej 5000 €, për shpenzime të mjekimit 86 €, kujdesin nga personi tjetër 600 €, ushqim të përforcuar 600 €; për paditësin G. P., për dhimbje fizike shumë prej 5000 €, shëmtim 5000 €, shpenzime të mjekimit 262 €, ndihëm nga personi tjetër 600 € dhe ushqim të përforcuar 600 € dhe për paditësin H. A., për dhimbje fizike shumë prej 5000 €, shëmtim 5000 €, shpenzime mjekësore 100 €, ndihmë nga personi tjetër 600 € dhe ushqim të përforcuar 600 €. Lidhur me këto pjesë të kërkesëpadisë gjykatat e instancës më të ulët kanë dhënë arsye të mjaftueshme për bazën e aprovimit të kërkesëpadisë të cilat arsye i pranon edhe kjo Gjykatë e revizionit. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, shumat e gjykuara në aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material dhe lidhur me shkallën e shëmtimit trupor. Vërtetimi i shpërblimit për dëmin jo material përfaqëson zbatim të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykatat sipas nenit 200 të LMD-së duhet të kujdesen për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për faktin që synimet e tilla të jenë të pajtueshme me natyrën dhe qëllimin shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë ligjore, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësit, shëmtimin trupor, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës mjekësore të ekspertëve Dr. I. K., Dr. N. M. – ortoped dhe Dr. M. H., psikiatër, e duke pasur parasysh edhe standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës, por edhe praktikën e deritanishme të gjykatave të Kosovës, shumat e cekur e shpërblimit të dëmit jo material të paditësve, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, është adekuate dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas dispozitës së cekur, andaj pretendimi i cekur në revizionin e të paditurës se këto shumat janë të larta u vlerësua si i pabazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës shumat e gjykuar me aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me zvogëlimin e aktivitetit jetësor për paditësin F. P. prej 25%, për paditësin G. P. prej 35 %, për paditësin H. A. prej 40 % dhe lidhur me frikën e përjetuar të të gjithë paditësit nuk është adekuate dhe nuk është në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit material. Gjatë caktimit të lartësisë së dëmit, gjykata duhet të vlerësojë kriteret e parapara me dispozitën e cekur më lartë, rëndësinë e vlerës së dëmtuar, andaj sipas vlerësimit të kësaj Gjykate shumat e gjykuara për këtë lloj dëmi material janë të larta dhe nuk janë në përputhje me kriteret e parapara, për të cilën arsye aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët në këtë pjesë janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe kjo Gjykatë

me zbatimin e nenit 224 të LPK, u dashtë që të njëjtën ta ndryshojë, ashtu që e obligoi të paditurën që paditësit F. P., për zvogëlimin e aktivitetit jetësor t'ia paguaj shumën prej 10.000 € për frikë shumën prej 3000 €; paditësit G. P., t'ia paguaj për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 13.500 €, për frikë shumën prej 3000 € dhe paditësit H. A., t'ia paguaj shumën prej 15.000 € për zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe për frikë shumën prej 3000 €, ndërsa shuma përtej shumës së gjykuar u vlerësua si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjeti se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas pretendimit në revizionin e të paditurës dhe as sipas shqyrtimit të aktgjykimit të kundërshtuar sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë të kuptueshëme dhe në harmoni me arsyetimin e aktgjykimit dhe provat e shtjelluara.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi pretendimin e cekur në revizionin e paditësve lidhur me shumën e gjykuar për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, por vlerësoi se qëllimi i shpërblimit për këtë lloj dëmi është zbutja e dëmit e shkaktuar me fatkeqësinë e komunikacionit, me ç'rast gjykata pati parasysh shkallën e dëmtimit, moshën e paditësve, por duke marrë parasysh edhe kriteret tjera si praktikën e gjykatave dhe faktin që me këtë rast mos të favorizohet asnjëra palë, ndërsa të arrihet qëllimi i drejt i shpërblimit.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 dhe nenit 224 par. 1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.47/2017 datë 10.5.2017

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku